



AKK-ja në arenën ndërkombëtare

- AKK-ja ka statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë të Këshillit të Evropës.
- Është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore).
- Statusin Asociacion i Ftuar (i ngjashëm me pozitën e anëtarit vëzhgues) në Komitetin Evropian të Komunave dhe Regjioneve (CEMR).
- Anëtar i ALDA-së (Asociacioni i Agjencive për Demokraci Lokale).



Asociacioni i Komunave të Kosovës është

SHTËPIA E KOMUNAVE

Rr "Gustav Mayer", Nr. 6. Prishtinë
 Tel. +381 (0) 38 245 734
 Fax. +381 (0) 38 245 733
 Email. info@komunat-ks.net
www.komunat-ks.net

AKK në Facebook



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është formuar në vitin 2001 pas zgjedhjeve të para demokratike lokale.

Themelimi i Asociacionit të Komunave të Kosovës është mbështetur në nenin 10 të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale në kuadër të Këshillit të Evropës (e drejta për asociacion) dhe Ligjin për Vetëqeverisjes Lokale të Kosovës.

AKK-ja është organizatë joprofitabile, është person juridik që i përfaqëson interesat e përgjithshme të anëtarëve të saj - autoritetet lokale.

VIZIONI

“Në shërbim të komunave për të avancuar demokracinë lokale dhe cilësinë e jetesës për qytetarët e tyre”

OBJEKTIVAT

- Nxitja e decentralizimit të pushtetit, përmes mbështetjes praktike dhe bashkëpunimit mbi baza të barabarta, mes Autoriteteve qendrore dhe atyre lokale;
- Zgjerimi i mbështetjes publike për demokracinë lokale që përfshin qytetarët dhe komunitetin e biznesit dhe ngritja e besimit në vetorganizimin e tyre dhe gatishmërisë së tyre për të marrë pjesë në qeverisjen lokale;
- Shtimi i kompetencave, njohurive dhe kapaciteteve të Komunave për të siguruar kualitete të larta dhe efektive në shërbimet lokale;
- Gjetja e burimeve alternative financiare për Komunitat;
- Demonstrimi se Komunat e Kosovës janë të barabarta dhe kanë partneritet kompetitiv me Autoritetet lokale në Evropë dhe në mbarë Botën;
- Mbështetja e zhvillimit të Asociacionit në përputhje me ndryshimet në qarqet e brendshme dhe të jashtme.



**Kryetari i
Asociacionit
të Komunave
të Kosovës
z.Agim Veliu**

ORGANET UDHËHEQËSE TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE

Kuvendi - Organi më i lartë i qeverisjes së Asociacionit është Kuvendi të cilin e përbëjnë të gjithë anëtarët e tij (132). Kuvendet Komunale e delegojnë për çdo 10 këshilltar një përfaqësues në Asociacion. Autoritetet lokale i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Asociacionit, në proporcion me numrin e votave që partia i ka fituar në Kuvendin Komunal.

Këshilli - Këshillin e Asociacionit të Komunave të Kosovës e përbëjnë 34 kryetarët e komunave dhe anëtarët e Bordit.

Bordi - Bordi i Asociacionit zgjedhet nga anëtarët e Kuvendit të Asociacionit. Bordi përbëhet prej 7 anëtarëve: kryetari, nënkryetari dhe pesë anëtarë tjerë. Në Bord respektohet përfaqësimi i partive politike dhe i pakicave.

Ekzekutivi - Administrata e Asociacionit udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv dhe përbëhet nga tre menaxher dhe nga 10 zyrtarë tjerë.

Kolegjiomet e AKK-së

Kolegjiomet e AKK-së (15) janë një ndër mekanizmat bazik të AKK-së dhe janë të konceptuar në atë mënyrë që të përfshijnë në vete të gjitha komunat, përkatësisht drejtorët e drejtorive komunale apo zyrtarët në secilin sektorë.

- Kolegjiomi për Planifikim Hapësinor,
- Kolegjiomi për Shërbime Publike,
- Kolegjiomi për Arsim dhe Kulturë,
- Kolegjiomi për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale,
- Kolegjiomi për Financa dhe Buxhet,
- Kolegjiomi për Administratë,
- Kolegjiomi për Kryesuesit e Kuvendeve Komunale
- Kolegjiomi për Ekonomi dhe Zhvillim,
- Kolegjiomi për Inspeksionin Komunal,
- Kolegjiomi për Zyrtarët Ligjor,
- Kolegjiomi për Integritime Evropiane,
- Kolegjiomi për Teknologji Informative,
- Kolegjiomi për Transparencë,
- Kolegjiomi për Prokurim dhe
- Kolegjiomi për Personel.



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština

www.komunat-ks.net

Shqip | English | Srpski

Forumi | MAP | Kontakti